



Pratje Number	Drejtori Director	13	10	2022	2	viti god year
Organizata Org. Unit	Nr. Prot. to Pr. A Prot. No	SKIPMS/OK 6157/2022			Sasia Kolicina Quantity	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.186/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1515/19 të datës 01.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A/02/531/2014 të datës 04.11.2014, të parashtruar nga ankuesja

të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat

në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A/02/531/2014 e datës 04.11.2014 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja sipas Akt Emërimit me numër 148A/13 të datës 01.09.2013 në Komunën e Leposaviqit në pozitën "Daktilografe", fillimisht me datën 10.12.2013, ka parashtruar kërkesën me numër 1 05 118-157 tek Komuna e Leposaviqit, lidhur me shkuarjen në pensionim për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Në bazë të Vendimit të datës 31.07.2014 të Kryetarit të Komunës së Leposaviqit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbim civil duke u larguar nga lista e pagave nga muaji gusht të vitit 2014. Ankuesja e pa kënaqur me heqjen nga lista e pagave, me datën 09.09.2014 parashtron kërkesën për sqarim të Kryetari i Komunës së Leposaviqit lidhur me largimin nga lista e pagave për muajin gusht të vitit 2014. Kryetari i Komunës së Leposaviqit, me datën 25.09.2014 i është përgjigjur kërkesës së ankueses, me arsyetimin se e njëjta nuk është paguar për muajin gusht të vitit 2014 sepse në muajin dhjetor të vitit 2013 e ka realizuar të drejtën për shkuarje në pensionim dhe mbi bazën e kësaj edhe është nxjerrë vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës. E pakënaqur me vendimin për largim nga lista e pagave,

ankuesja me datën 30.09.2014 i është drejtuar me ankesë Kryetarit të Komunës së Leposaviqit si dhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të kësaj komunës lidhur me largimin nga lista e pagave për muajin gushtë të vitit 2014 .

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit nuk ka shqyrtuar ankesën e ankueses, ndërsa kjo e fundit me datën 04.11.2014 parashtron ankesë me numër të protokollit 3299/2014 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor së në mënyrë të paligjshme i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë jo ligjore dhe se është larguar nga lista e pagave për muajin gushtë të vitit 2014 .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me rastin e shqyrtimit të ankesës të datës 04.11.2014, me Vendimin me numër A/02/531/2014 të datës 03.02.2015, është shpall jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me numër A/02/531/2014 të datës 03.02.2015 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.430/15 d të datës 06.02.2019 i pranuar në Këshill me datë 08.03.2019, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses Milijana Çosiç, duke anuluar Vendimin me numër A/02/531/2014 të datës 03.02.2015 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit nuk ka mundur të rishqyrtoj ankesën me numër A.02/531/2014 të datës 04.11.2014, kështu që me datën 17.09.2019 ka udhëzuar ankuesen për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 01.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1515/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për kërkesën e ankuesit të datës 08.05.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e vendosjes në lidhje me këtë ankesës ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.430/15 d të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Procesverbalin A.nr.430/15 d të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të datës 06.02.2019; Autorizimin e datës 02.03.2015 nga përfaqësuesi i ankuesve; Kërkesën e datës 08.05.2019 të përfaqësuesit të ankuesve në Këshill; Aktgjykimin A.nr.1515/2019 të datës 13.09.2022; Kërkesën për informata zyrtare të datës 03.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës drejtuar Komunës së Leposaviqit; Përgjigjen në padi të datës 12.11.2018; Aktvendimin A.nr.430/15 të datës 09.10.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Padinë e ankueses e parashtruar përmes përfaqësuesit ligjor të datës 06.03.2015; Precizimin e padisë së ankueses përmes përfaqësuesit ligjor të datës 08.10.2018; Vendimet A/02/535/2014, A/02/527/2014, A/02/528/2014, A/02/532/2014; A/02/533/2014, A/02/531/2014 të datës 03.02.2015; Përgjigjen në aktvendim të datës 06.07.2018 nga KPMSHCK; Aktvendimin e datës 14.05.2018 lidhur me detyrimin për përgjigje në padi; Vendimin e datës 31.12.2014 për vazhdimin e afatit të ankesave në Këshill; Akt emërimit e ankueses të datës 01.09.2013; Përgjigjen e datës 25.09.2014 nga Komuna e Leposaviqit për ankuesen; Kërkesën e

KOSOVA
KESHILLI I PAVARUR
MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL
17.11.2019
SHEKIP

ankueses të datës 09.09.2014 drejtuar Komunës së Leposaviqit; Ankesën e ankueses të datës 04.11.2014 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Listën e pagave për muajin mars, prill, qershor dhe korrik të vitit 2014; Kërkesën e ankueses të datës 09.09.2014 drejtuar Komunës së Leposaviqit; Përgjigjen e datës 25.09.2014 nga Komuna e Leposaviqit; Ankesën e ankueses të datës 30.09.2014 e parashtruar tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave si dhe Komunës së Leposaviqit; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Autorizimin e datës 03.10.2014 nga përfaqësuesi i ankuesve; Vendimin e datës 31.07.2014 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit; Shkresën zyrtare të datës 01.08.2014; Aktvendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës të datës 20.12.2013; Shkresën zyrtare të datës 30.01.2015 nga DASHC/MAP; Kërkesën për informata zyrtare të datës 19.12.2014 nga DASHC; Përgjigjen në kërkesën e ankueses nga Komuna e Leposaviqit të datës 22.11.2014; Përgjigjen në kërkesën e ankueses nga Komuna e Leposaviqit të datës 10.12.2013; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.11.2014 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe duke bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.430/15 d të datës 06.02.2019 dhe Aktgjykimin me numër A.nr.1515/19 të datës 01.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe të pranuar në këshill më datë 13/09/2022 me nr.pro.5358/2022, si dhe pas administrimit të të gjitha provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses, është e pa bazuar, *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se ankuesja posedon Akt Emërim me Nr.148A/13 të datës 01.09.2013, sipas së cilës e njëjta ka mbajtur pozitën e punës "Daktilografe" në Komunën e Leposaviqit, si nëpunëse e karrierës pa afat dhe se gjatë periudhës Mars-Korrik 2014 ka qenë në listën e pagave të Punëtorëve të Komunës së Leposaviqit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, e cila pretendon se Kryetari i Komunës së Leposaviqit, në mënyrë të paligjshme i ka ndërprerë marrëdhënien e punës dhe e ka pezulluar nga të ardhurat personale, duke shtuar me tej se ankuesja posedon kontratë të rregullt pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe bazuar në vërejtjet sipas aktgjykimit A.nr.430/15 d të datës 06.02.2019 vëren se ankuesja kishte mbajtur pozitën "Daktilografe" në Drejtorinë e Administratës të Komunës së Leposaviqit, sipas Akt Emërimit me numër 148A/13 të datës 01.09.2013.

Po nga shtjellimi i shkresave të lëndës Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil (me tej DASHC) pranë Ministrisë së Administratës Publike, përmes shkresës së datës 30.01.2015, ka konfirmuar se DASHC-ja nuk ka pranuar asnjë kërkesë nga Komuna e Leposaviqit dhe nuk ka miratuar ndonjë kërkesë për shpallje të konkursit lidhur me pozitën e ankueses.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 3 paragrafi 2 ku përcaktohet se: "*Nëpunësit civil punësohen në bazë të meritës, pasi t'i jenë nënshtruar procedurës përzgjedhëse, e përcaktuar në bazë të këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore*", ndërsa neni 19 i po të njëjtit ligj ka paraparë se:

"Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike,...", dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pranimi në Shërbimin Civil bëhet vetëm përmes procedurës së caktuar të rekrutimit. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh se emërimi i ankueses në pozitën e Daktilografes në Komunën e Leposaviqit, është bërë pa ndonjë procedurë pranimi, nga se nuk na është ofruar asnjë dëshmi nga asnjëra palë në procedurë se e njëjta në mënyrë të ligjshme e ka fituar këtë pozitë të nëpunëses civile, në këtë kuptim Kolegji vlerëson së pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuara.

Në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht Nenit 51, një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nëse akti i tillë është nxjerrë me ndonjërin nga shkeljet e përcaktuara me nenin 52 të të njëjtit Ligj e me të cilin përcaktohet se: *1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:...; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; ...1.5. është në kundërshtim me ligjin material; ... e mbi këtë bazë si dhe duke u nisur nga konstatimi si më lartë se emërimi i ankueses në pozitën e Daktilografes në Komunën e Leposaviqit, është bërë pa procedurë rekrutimi, dhe me qenë së nuk janë zbatuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil atëherë asnjë akt administrativ që derivon nga një proces administrativ i paligjshëm nuk mund të prodhojë pasoja juridike dhe në këtë kuptim dhe bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kolegji konstaton se është i pabazuar pretendimi ankimor i ankueses në kuptim të përmbajtjes së dispozitave të potencuara si më lartë.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në shkresat e lëndës, dhe duke marrë për bazë shkresën e datës 30.01.2015, ku DASHC-ja, konfirmon se nuk ka pasur procedura të rekrutimit sa i përket ankueses për këtë pozitë, ndërsa ankuesja nuk ka arrit me asnjë dëshmi të provojë se këtë pozitë e ka fituar konformë dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, organi i punësimit nuk është përgjigje në kërkesën e këshillit të datës 03/10/2022 për të qartësuar disa dilema që lidhen me rastin, ndërsa poashtu me rastin e vendosjes në lidhje me rastin kolegji mori për bazë edhe deklarimin zyrtarë të kryetarit të komunës së Leposaviqit përmes shkresës së datës 22/11/2014 të pranuar në këshill më datë 01/12/2014 se ankuesja nga data 30/12/2013 nuk ka shkuar në punë dhe se edhe nga ankuesja nuk është ofruar asnjë dëshmi që konfirmohet se e njëjta ka punuar pas periudhës 03/10/2013, nga se prezenca në punë duhet të vërtetohet me listë të vijimit në punë e të nënshkruar nga i punësuar apo përmes sistemit elektronik e që nga ankuesja nuk është ofruar si dëshmi asnjë dokument zyrtarë sa i përket kësaj çështje dhe në këtë kuptim kjo çështje ka qenë e rregulluar edhe me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që ka qenë në fuqi në këtë periudhë përkatësisht nenin 59 paragrafi 1, sa i përket vijimit në punë ku shprehimisht parashihet *"Nëpunësit civilë janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit të tyre dhe gjatë orarit të përcaktuar për funksionimin e institucionit punëdhënës. Nëpunësit civilë janë të detyruar të respektojnë orarin e punës dhe ta shfrytëzojnë atë për kryerjen e detyrave të caktuara",* nuk mund të kërkohej pagë për punë që nuk është kryer pasi dispozitat e Ligjit për Pagat Nr. 03/L-147 neni 5 paragrafi 1 parasheh: *"Paga bazë, sipas këtij ligji është rezultat i çmimit të punës....."* dhe paragrafi 2 *" Paga bazë sipas këtij ligji është rezultat i angazhimit dhe përkushtimit të nëpunësit civil në pozitën e tij të punës.....",* poashtu mungesa në punë 2 ditë pa arsye është shkelje e rëndë-serioze e paraparë në nenin 6 paragrafi 1.13 edhe në rregulloren



Nr.04/2011,për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil si dhe bazuar në këtë rregullore përkatësisht nenin 8 paragrafi 1.4 është arsye për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe me qenë se ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës, në kuptim të këtyre dispozitave ankuesja siç e kemi potencuar edhe më lartë me asnjë provë nuk ka arrit të dëshmojë se e njëjta ka punuar gjatë periudhës kur kërkon kompensimin, andaj pretendimi në këtë kuptim i ankueses është i pabazuar.

Poashtu kolegji analizoi përmbajtjen e ankesës sa i përket kthimit të ankueses në punë dhe konstatoi se me qenë se e njëjta tashmë është mbi moshën 65 vjeqare, e lindur më datë 08/03/1953, në kuptim të dispozitave të legjislacionit të Shërbimit Civil aktual e njëjta nuk mund ta ketë statusin e nëpunësit civil dhe mbi këtë bazë nuk u lëshua në shqyrtim të mëtutjeshëm të këtij pretendimi ankimor.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në vërejtjet sipas Aktgjykimit A.nr.430/15 të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1,nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda,A.nr.186/2021, datë 13.10.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat
- Kryetarit të Komunës së Leposaviqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Leposaviqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.